



Bazuar në Nenin 35, paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77 / 16 Gusht 2012) dhe nenin 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11 / 11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2012, miratoj si vijon:

**RREGULLORE  
PËR NORMËN EFEKTIVE TË INTERESIT  
DHE KËRKESAT PËR SHPALOSJE**

**Neni 1  
Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i metodologjisë së unifikuar për llogaritjen dhe shpalosjen e normës efektive të interesit për kredit e dhëna dhe depozitat e marra, dhe kërkesat minimale të shpalosjeve në mënyrë që të sigurohen informata të plota dhe të sakta rreth produkteve dhe shërbimeve të bankave për klientët.
2. Metodologjia e unifikuar e llogaritjes dhe shpalosjes së normës efektive të interesit dhe informatave tjera rreth produkteve dhe shërbimeve, ka për qëllim ti mundësoj klientëve krahasimin e lehtë dhe të drejtë ndërmjet institucioneve financiare, lidhur me shpenzimet dhe përfitimet nga produktet dhe shërbimet e tyre, si dhe mundësinë e matjes së kostos reale të kredisë dhe kthimin real nga depozitat, duke e rritur transparencën në treg.
3. BQK kërkon që tarifat për produktet dhe shërbimet bankare të jenë të lidhura direkt me koston e ofrimit të këtyre produkteve dhe shërbimeve, kështu që bankave mund të ju kërkohet nga BQK-ja të justifikojnë tarifat të cilat i vendosin. BQK pret që gjatë vendosjes së çmimeve për produktet dhe shërbimet që ofrojnë, bankat të ndikohen nga dëshira e vendosjes së çmimeve sa më të favorshme dhe të përbalueshme që është e mundur.
4. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja (në vijim: *bankat*) të licencuara nga BQK për të operuar në Republikën e Kosovës.

**Neni 2  
Përkufizimet**

1. Të gjitha termat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termat e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: *Ligji për Bankat*) dhe/ose termet e përkufizuara në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:

- a) “*Kredi*” nënkupton çdo hua ose zotim ligjor direkt apo indirekt për dhënien e një shume parash me të drejtën e kthimit të asaj shume të dhënë dhe të papaguar dhe të pagesës së interesit ose ndonjë detyrimi tjetër në atë shumë;
- b) “*Depozitë*” nënkupton shumën e parave të paguara nga një person fizikë apo juridikë në bankë, e cila pranohet nga banka me kusht që të ri-paguhet plotësisht, me ose pa interes ose premium, qoftë me kërkesë të ose në kohën e caktuar sipas marrëveshjes me atë person fizikë apo juridikë;
- c) “*Normë e interesit*” nënkupton normën e interesit të shprehur si përqindje fikse apo të ndryshueshme e aplikuar në bazë vjetore në shumën e aprovuar të kredisë apo në shumën e depozitës së pranuar nga banka;
- d) “*Norma Efektive e Interesit - NEI*” nënkupton koston totale të kredisë ose kthimin e depozitës, të paraqitur si normë vjetore e vlerës totale të kredisë ose kthimit total nga depozita, dhe e llogaritur sipas metodologjisë së paraqitur në nenin 4 dhe Aneksin 1 të kësaj rregullore, përmes së cilës hyrjet e diskontuara të parasë së gatshme duhet të barazohen me daljet e diskontuara të parasë së gatshme, dhe e cila i referohet kredive të dhëna ose depozitave të pranuar nga bankat. Për diskontim duhet të përdoret numri aktual i ditëve (kalendarike) të muajit dhe viti me 365/366 ditë;
- e) “*Kostoja totale e kredisë për klientin*” nënkupton të gjitha kostot, përfshirë interesin, komisionet, taksat dhe çdo lloj tjetër të shpenzimeve që banka i kërkon klientit ti paguaj, në lidhje me marrëveshjen/kontratën e kredisë; shpenzimet tjera të detyrueshme lidhur me marrëveshjen e kredisë, në veçanti premiumet e sigurimit janë të përfshira gjithashtu, po që se një kontratë e një shërbimi të tillë është e obligueshme për marrjen e kredisë, ose për marrjen e kredisë me kushtet e publikuara dhe nëse një shërbim i tillë paguhet nga banka dhe i ngarkohet klientit ose klientit nuk i ofrohet mundësia e përzgjedhjes së ofruesit të një shërbimi të tillë;
- f) “*Reklamë*” nënkupton çdo formë të reklamimit, qoftë në publikime, në televizion apo radio, përmes njoftimeve, shenjave, etiketimeve, broshurave, katalogëve, listës së çmimeve, internetit ose materialeve tjera, ose në ndonjë mënyrë tjetër dhe referencat për publikimin e reklamës së normave të interesit duhet të sqarohen në përputhje me rrethanat.

### **Neni 3 Kërkesat për shpalosje**

1. Reklamimi i të dhënave për kredi dhe depozita nga bankat, në objektet e tyre ose nëpërmjet mediave, të cilat direkt apo indirekt paraqesin normën e interesit ose ndonjë informatë shtesë që konsiderohet si pjesë e koston së kredisë apo kthimit nga depozita, duhet gjithashtu të përmbajnë normën efektive të interesit.

2. Reklamimi nuk duhet të jetë mashtrues dhe i pasaktë dhe nuk duhet të keqinterpretoj kontratën për kredi ose depozitë. Reklamimi nuk duhet të referohet apo të përshkruaj një produkt apo shërbim si “pa pagesë” ose “pa shpenzime” (ose të përmbaj ndonjë term të ngjashëm) nëse ndonjë tarifë e mirëmbajtjes apo aktivitetit mund të ngarkohet mbi të.

3. Norma efektive e interesit nuk duhet të jetë më pak e dukshme në krahasim me të dhënat tjera, si dhe në shpalosjen e saj, bankat duhet të përdorin termin “*Norma Efektive e Interesit*”. Nëse ky term përsëritet më shumë se një herë, pastaj mund të përdoret shkurtesa NEI. NEI duhet të raportohet duke e rumbullakuar atë me së paku një (1) vlerë pas presjes dhjetore.

4. Para përzgjedhjes së produktit apo shërbimit dhe para lidhjes së kontratës, bankat duhet të sigurojnë informacionin komplet për klientin, lidhur me kushtet, afatet, normën e interesit dhe normën efektive të interesit, si dhe tarifën tjera që i kërkohet klientit ti paguaj për palët e treta në mënyrë që të marrë kredinë. Bankat gjithashtu duhet të informojnë klientët për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, përfshirë këtu çdo shpenzim apo ndëshkim (dënim) të mundshëm në të ardhmen dhe kushtet e aplikimit të tyre, si dhe rreziqet e shoqëruara me marrjen e një produkti apo shërbimi të tillë. Ky informacion duhet të sigurohet në formë të shkruar për klientin dhe para nënshkrimit të kontratës.

5. Para lidhjes së kontratës për kredi apo depozitë, banka duhet të informojë klientin për të drejtën e tij/saj për posedimin e draftit të kontratës pa pagesë, për të mundësuar shqyrtimin e kontratës para nënshkrimit të saj, dhe me kërkesën e klientit, banka duhet ti ofrojë draftin e kontratës për produktin apo shërbimin për të cilin ai/ajo është i/e interesuar.

6. Bankat nuk duhet të ndryshojnë përmbajtjen e marrëveshjes/kontratës së një produkti apo shërbimi të nënshkruar nga klienti, përveç pjesëve të cilat lejohet të ndryshohen me legjislacionin në fuqi dhe me marrëveshjen ndërmjet palëve, por vetëm me njoftimin paraprak në formë të shkruar, individualisht të secilit klient që është subjekt i një ndryshimi të tillë. Njoftimi duhet të dorëzohet së paku një (1) muaj para se një ndryshim i tillë të bëhet efektiv dhe duhet të përmbajë informacion të saktë dhe të plotë, si dhe duhet paraqitur në një formë të kuptueshme për klientin.

7. Banka u ofron klientëve të saj, në intervale kohore që nuk e kalojnë një muaj kalendarik një pasqyrë të llogarisë, në të cilën shënohet çdo kreditim dhe debitim i regjistruar në llogari që nga dhënia e pasqyrës së fundit si dhe për bilancin përfundimtar të llogarisë. Pasqyra e llogarisë mund të dërgohet përmes postës, në formë elektronike apo ti jepet mbajtësit të llogarisë personalisht, ose në ndonjë formë tjetër varësisht nga zgjedhja e klientit. Mënyra e marrjes së pasqyrës së llogarisë duhet të shpaloset për klientin para se të hapet llogaria, përfshirë këtu edhe mënyrën e dërgimit të saj te klienti dhe mundësinë e përzgjedhjes së mënyrës së pranimit nga klienti.

8. Bankat informojnë paraprakisht klientin, para lidhjes së kontratës, në rastet e përdorimit të kartave të debitit dhe kreditit, mbi kushtet e përdorimit dhe komisionet e ngarkuara për veprimet që kryhen me kartë, në veçanti përmes bankomateve dhe pikave të shitjes (ATM-të dhe POS-të) së bankës apo përmes bankomateve dhe pikave të shitjes së bankave tjera. Ky informacion ofrohet për klientin edhe pranë bankomateve të bankës.

9. Bankat hartojnë dhe miratojnë metodologjinë/politikën e kalkulimit të çmimeve për kreditë dhe depozitat që ofrojnë, e cila duhet të përcaktoj me rregulloret e brendshme të tyre, si në vijim:

- a) normën e interesit dhe normën efektive të interesit të aplikuar për kreditë dhe depozitat në pajtim me kërkesat e kësaj rregulloreje;

- b) komisionet, tarifat dhe shpenzimet tjera të ngarkuara për produktet dhe shërbimet e ofruara në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe kostot tjera të mundshme në të ardhmen nëse përmbushen kushtet e paracaktuara.

10. Në rastet kur banka njoftohet nga klienti përmes adresës apo numrit të telefonit, të cilat duhet të përcaktohen paraprakisht nga ana e bankës dhe duhet ti shpalosen klientit me rastin e nënshkrimit të kontratës, për një kartë krediti apo debiti të humbur apo të vjedhur, banka nuk mund të vendos përgjegjësinë ndaj klientit për dëmet e shkaktuara nga transaksionet e kryera me atë kartë pas njoftimit të pranuar nga klienti.

#### **Neni 4**

#### **Metodologjia për llogaritjen e normës efektive të interesit për kreditë**

1. Norma efektive e interesit llogaritet sipas formulës matematikore të paraqitur me **Aneksin 1** të kësaj rregullore.

2. Për qëllim të llogaritjes së normës efektive të interesit, kostoja totale e kredisë për klientin e përkufizuar në paragrafin e) të nenit 2 të kësaj rregulloreje, nuk do të përfshijë:

- a) Shpenzimet që nuk njihen në datën e llogaritjes, por që mund të ndodhin gjatë pagimit të kredisë;
- b) Shpenzimet të cilat i paguan klienti në rastet kur nuk përmbush ndonjë nga zotimet e tij të paracaktuara me marrëveshjen e kredisë;
- c) Shpenzimet e ndryshme nga çmimi i blerjes, të cilat duhet ti paguaj klienti për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nëse blerja bëhet me para të gatshme ose me kredi me këste, me kusht që banka nuk do të jetë përfituesi i fundit i këtyre pagesave;
- d) Shpenzimet e klientit ndaj palëve të tjera (për shembull: noteri publik, autoriteti i taksave, regjistri i hipotekave) përgjatë përpilimit të marrëveshjes së kredisë dhe çdo shpenzim tjetër për regjistrim dhe garanci. Megjithatë, të gjitha këto shpenzime duhet të shpalosen me shkrim dhe në formë të qartë për klientin para realizimit të kontratës.
- e) Shpenzimet e sigurimit që janë të obligueshme për marrjen e kredisë, apo për marrjen e kredisë me kushtet specifike të ofruara, në rastet kur ato mund ti paguaj klienti në kompaninë e sigurimit që mund ta përzgjedhë vet. Këto shpenzime duhet të shpalosen nga banka, përveç normës efektive të interesit, me shpjegimin se premiumi i sigurimit është i obligueshëm, por nuk është i përfshirë në llogaritjen e normës efektive të interesit.
- f) Shpenzimet e sigurimit që nuk janë të detyrueshme për marrjen e kredisë apo marrjen e kredisë me kushtet specifike të ofruara;
- g) Çdo shpenzim që klienti i paguan bankës vetëm kur:
  - i. Kredia në dispozicion nuk është shfrytëzuar në tërësi apo pjesërisht;
  - ii. Klienti kërkon ndryshimin e afateve të pagesave dhe një ndryshim i tillë i është pranuar nga ana e bankës.

3. Shpenzimet për mirëmbajtjen e një llogarie për regjistrimin e pagesave dhe për disbursim, shpenzimet e përdorimit të një mjete tjetër për pagesa dhe shfrytëzim të kredisë, si dhe kostot tjera lidhur me transaksionet e pagesave të kredisë, duhet të përfshihen në koston totale të kredisë për klientin, përveç nëse klientit i mundësohet zgjedhja e institucionit për hapjen e llogarisë për kryerjen e këtyre shërbimeve, (d.m.th. klienti nuk detyrohet që të hapë llogari me një bankë të veçantë) dhe shpenzimet e mirëmbajtjes së llogarisë janë shpalosur qartë dhe në mënyrë të ndarë me marrëveshjen e kredisë apo me ndonjë marrëveshje tjetër të realizuar me klientin;

4. Norma efektive e interesit llogaritet bazuar në supozimin që marrëveshja e kredisë është e vlefshme për periudhën e dakorduar dhe palët përmbushin detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara me marrëveshjen e kredisë.

5. Në rastin e marrëveshjeve të kredisë që përmbajnë dispozita, që lejojnë ndryshime në normat e interesit ose shpenzimet tjera që përfshihen në normën efektive të interesit, por të pamatshme në kohën kur kjo normë llogaritet, norma efektive e interesit llogaritet duke supozuar që përqindja e interesit dhe shpenzimet tjera mbeten të pandryshuara (fikse), në lidhje me nivelin fillestar dhe do të mbeten të aplikueshme deri në përfundimin e obligimeve të marrëveshjes së kredisë.

6. Banka duhet të parashikojë në kontratën e kredisë mënyrën e njoftimit të klientit për çdo ndryshim të elementeve bazë të llogaritjes së normës efektive të interesit dhe njoftimi duhet të kryhet përpara se të zbatohet një ndryshim i tillë.

7. Në momentin e nënshkrimit të kontratës së kredisë, banka duhet të përgatis për klientët e saj, tabelën e pagesave (planin e amortizimit), së bashku me normën efektive të interesit të paraqitur në mënyrë të qartë. Gjithashtu, banka duhet të bashkëngjis një kopje të planit të amortizimit, të nënshkruar nga klienti, me dosjen e kredisë përkatëse.

8. Sipas nevojës, për llogaritjen e normës efektive të interesit dhe nëse aplikohen, mund të përdoren edhe supozimet e paraqitura në **Aneksin 1**, si dhe për sqarime shtesë janë paraqitur shembujt në **Aneksin 2** të kësaj rregullore.

9. Bankat duhet të dorëzojnë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, në baza tremujore, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas çdo tremujori, raportet mbi normat efektive të interesit për të gjitha produktet dhe shërbimet që ofrojnë për klientin.

## **Neni 5**

### **Elementet e marrëveshjes (kontratës) së kredisë**

1. Çdo marrëveshje (kontratë) e kredisë duhet të jetë në formë të shkruar, të nënshkruhet nga palët kontraktuese dhe të përmbaj së paku elementet në vijim:

- a) Llojin e kredisë (këstet, afatet etj);
- b) Qëllimin i përdorimit të kredisë;
- c) Identifikimin dhe adresat gjeografike të palëve kontraktuese;
- d) Kushtet specifike të kredisë që lidhen me shumën, valutën, datën e dhënies, datën e maturimit, normën e interesit dhe llojin e saj (fikse apo variabile), indeksin orientues në rastet e normës variabile (euribor, libor etj), normën efektive të interesit, shpeshtësinë e ndryshimit të normës efektive të interesit apo pjesëve përbërëse të saj, këstet mujore të pagesave për shlyerjen e kredisë dhe datat ose periudhën e shlyerjes;

- e) Komisionin fillestar të paguar nga klienti (nëse aplikohet) ose komisionet e ndryshme në momentin e pranimit apo gjatë shlyerjes së kredisë;
- f) Në rastet e kredisë në formë të pagesave të shtyra për mallra apo shërbime të veçanta apo në rastet e marrëveshjeve të lidhura për kredi, llojin e mallit apo shërbimit dhe çmimin e tij me para të gatshme;
- g) Shumën totale të pagueshme nga klienti, të llogaritur në momentin e realizimit të kontratës së kredisë;
- h) Në rastet kur aplikohet, komisionet për mirëmbajtjen e një apo disa llogarive për transaksionet e pagesave dhe tërheqjeve lidhur me kredinë (përveç nëse përzgjedhja e llogarisë për kryerjen e këtyre transaksioneve është e mundshme për klientin), si dhe çdo tarifë tjetër që rrjedhë nga marrëveshja e kredisë dhe kushtet kur ato janë të aplikueshme;
- i) Normën e aplikueshme të interesit në rast të vonesave në pagesën e kësteve, siç aplikohet në momentin e realizimit të kontratës së kredisë dhe mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe çdo tarifë apo gjobë të pagueshme për vonesë dhe kushtet e aplikimit të tyre;
- j) Paralajmërimin lidhur me pasojat në rastet e mos pagimit të kësteve në afat të caktuar;
- k) Nëse është e aplikueshme, një deklaratë për obligimin e pagesës së komisionit të noterit për regjistrim, garanci apo pagesë për palët e treta që kërkohet për kredinë;
- l) Nëse aplikohet, deklarata për posedimin e policës së sigurimit apo shërbimet tjera ndihmëse, kur janë të detyrueshme për marrjen e kredisë apo marrjen e kredisë me kushte specifike;
- m) Llojin e kolateralit (nëse ekziston);
- n) Detyrimet dhe ndëshkimet (dënimet) e palëve dhe rastet kur ato lindin dhe zbatohen;
- o) Mënyrën e ndryshimit të kushteve të kontratës dhe përfundimit të saj;
- p) Numrin e kopjeve të nënshkruara në origjinal të kontratës dhe mënyrën e disponimit të tyre nga palët kontraktuese.

2. Me rastin e dhënies së kredisë ose në momentin e ristrukturimit të saj, banka i ofron klientit:

- a) Planin e amortizimit, në momentin e lidhjes së marrëveshjes së kredisë dhe në rastet e ristrukturimit, i cili duhet të përmbajë shumat e kësteve dhe periudhat e pagesës së tyre dhe ndarjen e secilës pagesë në shtyllën e kryegjësë së amortizuar, interesit të llogaritur dhe kur janë të aplikueshme kostot tjera të kërkuara;
- b) Planin e të gjitha pagesave të paracaktuara dhe të njohura, që klienti paguan në procesin e marrjes së kredisë dhe gjatë kohëzgjatjes së saj, si ato fikse apo variabile. Banka duhet të shpalos për klientin shpenzimet që përfshihen dhe shpenzimet që nuk përfshihen në llogaritjen e normës efektive të interesit;
- c) Shpenzimet dhe ndëshkimet (dënimet) tjera të mundshme në të ardhmen dhe kushtet kur ato aplikohen;
- d) Në rastet e normave variabile të interesit, një paralajmërim me shkrim për rrezikun nga lëvizjet e normës së interesit gjatë kohëzgjatjes së kredisë, si rezultat i rritjes së indeksit orientues.
- e) Në rastet e kredive konsumuese përfshirë kartat e kreditit, mbitërheqjet ose forma tjera të ngjashme të kreditit, kushtet e dhënies, shfrytëzimit dhe pagesës së tyre dhe të gjitha ndëshkimet e mundshme lidhur me to dhe kushtet kur ato mund të aplikohen, duhet të paraqiten hollësisht në kontratë;
- f) Ndëshkimi i parapagimit. Nëse aplikohet ndëshkimi për pagimin në tërësi apo të pjesshëm të kryegjësë përpara afatit të caktuar, duhet ti shpaloset klientit së bashku me metodën e llogaritjes së saj.

3. Në rastet e marrëveshjeve të kredisë në formë të linjave kreditore, mbitërheqjeve dhe kartave të kreditit, bankat përveç elementeve të aplikueshme të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 5, specifikojnë me shkrim edhe informacionin në vijim:

- a) Kufirin fillestar të kredisë, nëse është i njohur në momentin e lidhjes së kontratës;
- b) Llojin dhe shumën e secilës pagesë tjetër të ndryshme nga norma e interesit;
- c) Pagesën minimale të kërkuar gjatë çdo periudhe të pagesës ose metodën e kalkulimit të saj;
- d) Datën e llogaritjes së interesit dhe informacionin në lidhje me periudhën e lejuar për pagesë;
- e) Të dhënat e komisioneve dhe gjobave dhe kushtet kur ato janë të aplikueshme;
- f) Shumen e kërkuar të kolateralit që shërben si garanci për marrjen e kredisë;

## **Neni 6**

### **Elementet e marrëveshjes (kontratës) së depozitës**

1. Për çdo llogari dhe depozitë të hapur nga klienti pranë bankës, nënshkruhet një kontratë nga palët pjesëmarrëse në transaksion. Kontrata është një akt i veçantë, i ndryshëm nga dokumentet e aplikimit për hapjen e llogarisë.

2. Në secilën kontratë të llogarive rrjedhëse apo të kursimit, përveç të dhënave personale të palëve kontraktuese dhe numrit të llogarisë, duhet të përfshihen së paku:

- a) Norma e interesit dhe metoda e llogaritjes së saj;
- b) Norma efektive e interesit dhe për llogaritë e kursimit shuma totale e cila do të merret nga depozitori;
- c) Shpeshtësia e pagesave të interesit;
- d) Masa e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat nga interesat dhe metoda e llogaritjes së saj;
- e) Komisionet për mirëmbajtjen e llogarisë; dhe
- f) Komisionet dhe ndëshkimet tjera të mundshme dhe kushtet e aplikimit të tyre.

Elementet e paraqitura në shkronjat a), b) dhe c) përfshihen në kontratë në rastet kur banka aplikon interes për llogarinë rrjedhëse dhe/ose llogarinë e kursimit.

3. Kontrata e depozitave me afat, përveç të dhënave personale të klientit, duhet të përmbajë së paku këto elemente:

- a) Shuma e depozitës me afat;
- b) Norma e interesit dhe shpeshtësia e pagesës së saj;
- c) Norma efektive e interesit dhe shuma totale e depozitës që do të merret nga konsumatori në rastin e maturimit të depozitës me afat;
- d) Shuma e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat nga interesi;
- e) Data e maturimit të depozitës;
- f) Kushtet e zgjedhura nga klienti për ripërtëritjen e llogarisë së depozitës me afat pas maturimit, me automatizëm apo jo;
- g) Kushtet e anulimit (prishjes) së kontratës; dhe
- h) Ndëshkimet e aplikueshme në rastin e anulimit (prishjes) para kohe të kontratës, mënyra e llogaritjes dhe përcaktimit të tyre;
- i) Nëse llogaria nuk do të ripërtërihet automatikisht, duhet të precizohet në deklaratë se a do të llogaritet interesi pas maturitetit nëse klienti nuk e ripërtërinë afatizimin e depozitës apo jo.

j) Nëse ripërtëritja e depozitës pas maturimit nuk është automatike dhe nuk llogaritet interes pas maturimit, bankat duhet të caktojnë dhe shpalosin periudhën dhe mënyrën e njoftimit të klientit gjatë të cilës klienti mund të vendos për ripërtëritjen e llogarisë së depozitës me afat.

4. Bankat duhet të parashikojnë në kontratën e llogarisë, mënyrën e njoftimit të klientit për ndryshimin e mundshëm të kushteve apo afateve të kontratës së nënshkruar para se të aplikojë ndryshimin.

5. Në rast të ndryshimit të një elementi të kontratës, i cili afekton një apo më shumë klient, bankat duhet të informojnë secilin prej tyre me shkrim, së paku (1) muaj para se ndryshimi të jetë efektivë.

## **Neni 7** **Shpalosjet tjera**

1. Të gjitha bankat duhet të përgatisin listën e çmimeve dhe të gjitha tarifave për të gjitha produktet dhe shërbimet që ato ofrojnë, duke i shpalosur në mënyrë të dukshme dhe ajo listë duhet të jetë në dispozicion për të gjithë klientët e interesuar.

2. Bankat duhet të sigurohen që çdo degë dhe njësi e tyre që merret me shërbimin e klientëve të mbaj në çdo kohë listat e tilla të çmimeve të printuara, të cilat përmbajnë informacionin e nevojshëm të gatshme për klientin. Informacioni i tillë duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe duhet të jetë i publikuar edhe në ueb faqen e bankës.

3. Bankat duhet të sigurohet që listat e çmimeve të përditësohen rregullisht dhe nuk duhet të imponojnë tarifa të cilat janë më të larta se struktura e shpalosur e tyre ose të llogarisin tarifën e tyre në mënyrë kontradiktore me kriteret e shpalosura të llogaritjes.

## **Neni 8** **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Bankat që shkelin ndonjë nga dispozitat e kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave përmirësuese të parapara me nenet 58, 59 dhe 82 të Ligjit për Bankat.

## **Neni 9** **Dispozitat Kalimtare**

1. Bankat duhet të jenë në pajtueshmëri me dispozitat e kësaj rregulloreje brenda njëqindetëdhjetë (180) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të saj.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk aplikohen për marrëveshjet e kredive dhe depozitave të realizuara ndërmjet institucioneve financiare dhe për marrëveshjet e kredive dhe depozitave të realizuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.



**Neni 10**  
**Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregulla XXVI e BQK'së mbi Normat e Interesit, Shpalosjes së Tarifave dhe Reklamimeve e miratuar me 20 Mars 2008, dhe çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë rregullore.

**Neni 11**  
**Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi me 03 dhjetor 2012.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Sejdi Rexhepi

## Aneksi Nr.1

### Metoda e Llogaritjes së Normës Efektive të Interesit për Kredi

Ekuacioni bazë, për llogaritjen e normën efektive të interesit (NEI), barazon, mbi një bazë vjetore, **nga njëra anë** vlerën totale të tanishme të kredisë duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur (për shembull: shpenzimet administrative, shpenzimet e menaxhmentit etj), të vënë në dispozicion të klientit sipas marrëveshjes së kredisë dhe **në anën tjetër** vlerën totale të tanishme të shlyerjeve dhe/ose pagesave të shpenzimeve, d.m.th.:

$$\sum_{k=1}^m C_k (1 + X)^{-t_k} = \sum_{l=1}^{m'} D_l (1 + X)^{-S_l}$$

Ku:

- $X$  është NEI e cila mund të llogaritet (nga algjebra ose nga ndonjë program kompjuterik) kur termat e tjerë në ekuacion janë të njohur.
- $m$  është numri total i kësteve të kredisë, nëse shfrytëzimi i kredisë bëhet me këste, të paguara nga banka.
- $k$  është numri në vazhdimësi për këstet e kredisë, nëse shfrytëzimi i kredisë bëhet me këste, të paguara nga banka, rrjedhimisht  $1 \leq k \leq m$ ,
- $C_k$  është shuma e tërheqjes, vlera faktike e kredisë së vënë në dispozicion për klientin në periudhën  $k$ ,
- $t_k$  është intervali i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së tërheqjes së parë (këstit të parë të kredisë) të vënë në dispozicion për klientin (nëse shfrytëzimi i kredisë bëhet me këste) dhe datës së secilës tërheqje pasuese (çdo kësti pasues) të kredisë së vënë në dispozicion të klientit, prandaj  $t_1 = 0$ ,
- $m'$  është numri total i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagesave të shpenzimeve/tarifave;
- $l$  është numri në vazhdimësi i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë apo pagesave të shpenzimeve/tarifave,
- $D_l$  është shuma e këstit të shlyerjes apo pagesës së shpenzimeve/tarifave, nga klienti në periudhën  $l$ .
- $S_l$  është intervali, i shprehur në vite apo fraksione të një viti, ndërmjet datës së vlerës së këstit të parë të kredisë së vënë në dispozicion të klientit (nëse shfrytëzimi i kredisë bëhet me këste) ose datës së shfrytëzimi të kredisë, në rast se shfrytëzimi i kredisë bëhet i plotë dhe datës së secilit këst për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagimi i shpenzimeve / tarifave vijuese që paguan klienti.

## I. Shënime:

1. Shumat e paguara nga të dy palët në kohë të ndryshme, nuk duhet domosdosmërisht të jenë të barabarta dhe nuk duhet domosdosmërisht të paguhet në intervale të njëjta kohore.
2. Data e fillimit duhet të jetë ajo e pagimit të kështit të parë të shfrytëzimit të kredisë nga banka, nëse shfrytëzimi i kredisë bëhet me këste ose e datës së shfrytëzimit të kredisë, në rast të shfrytëzimit të plotë të kredisë në dispozicion të klientit;
3. Intervalet midis datave të përdorura në llogaritje duhet të shprehen në vite ose fraksione të vitit. Një vit pre supozohet të ketë 365 ditë ose 366 ditë për vitet e brishtë, 52 javë ose 12 muaj të barabartë. Një muaj i barabartë pre supozohet të ketë 30.41666 ditë (d.m.th.: 365/12) pavarësisht nëse është apo jo vit i brishtë.
4. Rezultatet e llogaritjes duhet të shprehen me një saktësi, të paktën me një (1) vlerë pas presjes dhjetore. Nëse numri vijues pas një vlere pas presjes dhjetore është më i madh ose i barabartë me 5, vlera e numrit pas presjes dhjetore duhet të rritet për një.
5. Ekuacioni mund të rishkruhet duke përdorur një shumë të vetme në rast të shfrytëzimit të plotë të kredisë nga banka ( $A_k$ ), e cila do të jetë pozitive apo negative, me fjalë tjera ose e paguar ose e pranuar gjatë periudhave 1 deri te k, e shprehur në vite, d.m.th.:

$$S = \sum_{k=1}^n A_k (1 + X)^{-t_k},$$

**S** – është vlera totale e tanishme e kredisë duke zbritur çdo shpenzim/tarifë të mbajtur, për shembull shpenzimet administrative, shpenzimet e menaxhmentit etj. Nëse qëllimi është të balancohen hyrje daljet, vlera e saj do të jetë zero.

Bankat duhet të sigurojnë që metodat e zgjidhjes së aplikueshme japin rezultat të barabartë me atë të shembujve të prezantuar në Aneksin II të kësaj Rregulloreje, në vijim.

## II. Supozimet plotësuese për llogaritjen e normës efektive të interesit:

1. Nëse marrëveshja e kredisë i jep klientit të drejtën për tërheqjen e fondeve të kredisë në çdo kohë dhe shumë që ai dëshiron, do të supozohet që kredia tërhiqet menjëherë dhe në total;
2. Nëse marrëveshja e kredisë përcakton mënyra të ndryshme të tërheqjes me aplikim të komisioneve dhe normave të ndryshme të interesit, do të supozohet që kredia do të tërhiqet me komisionin më të lartë të caktuar dhe normën e interesit më të lartë të aplikuar për rastet e tërheqjeve më të zakonshme për këtë lloj të marrëveshjeve të kredisë;

3. Nëse marrëveshja e kredisë i jep klientit të drejtën e tërheqjes në përgjithësi të fondeve të kredisë, por imponon, midis mënyrave të ndryshme, kufizimet lidhur me shumën dhe periudhën kohore të tërheqjeve, do të supozohet që shuma e kredisë tërhiqet në datën më të hershme të parashikuar në marrëveshje dhe në përputhje me limitet e caktuara të tërheqjeve;

4. Nëse nuk përcaktohet një plan fikse i kësteve, do të supozohet se:

a. kredia jepet për një periudhë një vjeçare; dhe

b. kredia do të paguhet në 12 këste të barabarta mujore;

5. Në rastet kur ka një plan fikse të kësteve për shlyerjen e kredisë, por shuma e kësteve të tilla është e ndryshueshme, do të supozohet që shuma e çdo pagese do të jetë shuma më e ulët e parashikuar me marrëveshje;

6. Përveç nëse përcaktohet ndryshe, kur marrëveshja e kredisë parashikon më shumë se një datë të ri-pagesës (shlyerjes), do të supozohet që kredia do të jetë e disponueshme dhe pagesat kryhen në datën më të hershme të përcaktuar me marrëveshje;

7. Në rastet e mbitërheqjeve, do të supozohet që kredia do të tërhiqet tërësisht dhe për tërë kohëzgjatjen e marrëveshjes së kredisë. Nëse kohëzgjatja e marrëveshjes së kredisë nuk është e ditur, NEI duhet të llogaritet me supozimin se kohëzgjatja e asaj kredie është tre muaj;

8. Nëse ofrohen norma të ndryshme të interesit dhe komisione të ndryshme për një periudhë ose një shumë (vlerë) të kufizuar kredia, norma e interesit dhe komisionet duhet të supozohet të jenë më të lartat për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes së kredisë;

9. Për marrëveshjet për kredi konsumuese për të cilat është rënë dakord për normë fikse të interesit për periudhën fillestare, në fund të së cilës caktohet një normë tjetër e interesit, dhe vazhdimisht e ndryshuar në baza të rregullta sipas një indeksi të rënë dakord, llogaritja e NEI duhet të bazohet në supozimin se, në fund të periudhës me normë fikse të interesit, norma e interesit është e njëjtë si në momentin e llogaritjes së saj, bazuar në vlerën e indeksit të rënë dakord në atë moment.

## Aneksi Nr.2

### Shembujt e Llogaritjes së Normës Efektive të Interetit për Kreditë

Qëllimi i shembujve të llogaritjes së NEI'së është ilustrimi me shembuj të zbatimit të llogaritjes së NEI sipas formulës së paraqitur në Aneksin Nr.1 dhe supozimeve të përdorura për lloje të ndryshme të produkteve dhe shërbimeve. Përdorimi i këtyre shembujve ju ndihmon bankave që të arrijnë rezultatet e njëjta gjatë implementimit të kësaj Rregulloreje.

Shembujt në vijim janë marrur nga raporti final i vitit 2009 i lëshuar nga Drejtorati i Shëndetësisë së Përgjithshme dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi Studimin e Llogaritjes së Përqindjes Vjetore të Shpenzimeve për Marrëveshjet e Kredive Konsumuese, që mund të gjendet në uebfaqen: [http://ec.europa.eu/consumers/rights/docs/study\\_APR\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/consumers/rights/docs/study_APR_en.pdf), me disa ndryshime nga ana e BQK'së për përshtatjen e tyre me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

Tabela 1 në vijim paraqet disa nga tiparet e përbashkëta të përdorura në shembujt në vijim për produkte të ndryshme kreditore.

**Tabela 1.**

Tiparet	Kreditë me Këste	Kreditë "Revolving" të përsëritshme në rrotacion
Shuma	€ 6000 (me përjashtim të 11, 14, 15)	€ 1000
Kohëzgjatja	2 vite (me përjashtim 1, 2, 15, 17)	Me përcaktim të një pagese minimale prej 20% e shumës në shfrytëzim, me një minimum prej € 20 (me përjashtim të 18, 19 and 20)
Shpeshtësia e pagesave	Mujore (me përjashtim të 1, 2, 14)	Mujore
Norma e interesit	9% vjetor (me përjashtim të 14, 15)	12% efektive
Komisionet dhe tarifatat tjera (kur kërkohen)	Shpenzimet administrative € 60	Shpenzimet administrative € 25 nëse kërkohet vetëm një pagesë ose €2.5 për muaj
Shpenzimet e sigurimit (kur kërkohen)	5% e shumës fillestare të kredisë	1.5% të shumës në shfrytëzim

Tabela 2 në vijim paraqet shembujt e përdorur në këtë aneks, përfshirë këtu një përshkrim të shkurt të tyre dhe tiparet që i dallojnë.

**Tabela 2**

Numri	Përshkrimi	Tiparet
<b>Kreditë me Këste</b>		
1	Kredi e paguar vetëm me një këst	Kohëzgjatja dhe numri i pagesave / kësteve
2	Kredi me katër këste vjetore	Kohëzgjatje dhe shpeshtësia e pagesave
3	Kredi me këste mujore	Këstet mujore
4	Kredi me këste me pagesën e parë të kryer brenda një numri të caktuar të ditëve	Periudha e pagesës së parë me gjatësi të ndryshme
5	Kredi me këste me shpenzime administrative	Shpenzimet administrative
6	Kredi me këste me shpenzime administrative të shpërndara me pagesat e rregullta të kësteve	Shpenzime të rregullta administrative
7	Kredi me këste me shpenzime administrative dhe premium të rregullt të sigurimit	Premium të rregullta të sigurimit
8	Kredi me këste me shpenzime administrative dhe një shumë e vetme për premiumin e sigurimit.	Premium të sigurimit të paguara vetëm një herë gjatë kohëzgjatjes së kredisë
9	Kredi “Balon” me shpenzime administrative dhe premium të rregullta të sigurimit	Pagesat “Balon”
10	Kredi me këste me një pagesë në formë të paradhënies dhe shpenzime administrative	Pagesa në formë të paradhënies
11	Kredi në formë të lizingut financiar	Pagesa si paradhënie plus pagesa përmbyllëse
12	Kredi me këste me shpenzime administrative dhe këste në zbritje	Këste në zbritje
13	Kredi me këste me shpenzime administrative dhe këste në rritje	Këste në rritje
14	Kredi me këste me këste të ndryshueshme	Këste të ndryshueshme
